

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“KRAM AL SH.P.K“**

**Neni 1  
Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është **“KRAM AL SH.P.K“** më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 3  
Forma ligjore**

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar, por mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4  
Kohëzgjatja**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

**Neni 5  
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga **“ Kavajes” Kompleksi Square 21, Shk 1, Seksioni D, Kati 0, njesia D7 & D8, Tiranë.**

Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 6  
Emblema, vula dhe të dhënat**

Të gjitha dokumentet e Shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen, nëse ka dhe vulën e saj.

Të gjitha dokumentet, shkresat, njoftimet, botimet dhe akte të tjera korrespondence të lëshuara nga Shoqëria në letër ose nëpërmjet mjeteve elektronike të cilat i drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat më poshtë:

- (i) fjalët **“Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”** ose **“shpk”**;
- (ii) numrin unik të identifikimit të biznesi;
- (iii) adresën e selisë;
- (iv) statusin e Shoqërisë nëse është në proces likuidimi; dhe



- (v) vlera e kapitalit të nënshkruar dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

## **Neni 7** **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Ushtrimin e aktivitetit Bar-Bufe-Pastiçeri.
- Prodhim dhe shitje të produkteve të brumit.
- Prodhim dhe shitje të akulloreve dhe ëmbëlsirave.
- Prodhim dhe shitje të antipastave.
- Prodhim dhe/ose shitje të pijeve alkoolike dhe joalkoolike.
- Dhe çdo gjë tjetër që përdoret konform objektit kryesor të Bar-Bufe-Pastiçeri.

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me kërkesat ligjore ose vendim të asamblesë së ortakut sipas ligjit dhe këtij Statuti.

## **Neni 8** **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 200.000 Lekë, dhe është i ndarë në dy kuota, ku 1 kuotë ose 50% të kapitalit i zoteron ortakut i Shoqërisë ;

- (a) **Andrin Kurti**, i biri i Sulejman, shtetas shqiptar, lindur në Kukës më 10.10.1983 banues në Tiranë në adresën Rruga “ Don Bosco” Kompleksi. Fiori di Bosco, Shk 2, Kulla 3, Kati 4, Apt.22, i pajisur me kartë ID me nr. 036504924 dhe nr. Personal I31010152S, madhor me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, zotues i një kuote në vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me vlerën 100.000 ( njëqind mijë ) Lekë. Vlera nominale e çdo kuote për çdo ortak është 100.000 (njëqind mijë ) Lekë.

Dhe 1 kuotë ose 50% të kapitalit nga ortakut tjetër i shoqërisë :

- (b) **Bledar Muça**, i biri i Bahir , shtetas shqiptar, lindur në Dushkë, Lushnjë më 21.04.1988 banues në Lushnjë në adresën Lagja Skënder Libohova, Rruga “ Vedut Dokollari” Shk 1, Kati 6, Apt.8, i pajisur me kartë ID me nr. 035470008 dhe nr. Personal I80421022C, madhor me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, zotues i një kuote në vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me vlerën 100.000 ( njëqind mijë ) Lekë. Vlera nominale e çdo kuote për çdo ortak është 100.000 (njëqind mijë ) Lekë.

Përgjegjësia e ortakut për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.



## **Neni 9** **Transferimi i kuotave**

Transferimi i kuotës përkatëse ose pjesëve të saj të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, dhurim ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

Në rast transferimi të kuotës ose pjesëve të saj tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje, dhurim apo çdo formë tjetër kalimi tek persona të tretë, ortakët që synon të transferojë kuotën përkatëse ose pjesë të saj (Ortakut Transferues) duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës ose pjesëve të saj nga Ortaku Transferues proporcionalisht me përqindjen e zotëruar në kapitalin e shoqërisë dhe këta ortakë të tjerë duhet ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të Ortakut Transferues për të transferuar kuotat.

## **Neni 10** **Zmadhimi/Zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 14 të këtij Statuti.

Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë. Në çdo rast kontributet në natyrë duhet të shoqërohen me një raport vlerësimi të kontributeve të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me propozim të administratorit/ëve, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit sipas nenit 14 të këtij Statuti.

## **Neni 11** **Organet e Shoqërisë**

Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Administratori.

## **Neni 12** **Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë. Asambleja e



Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresë të ortakut të Shoqërisë të regjistruar në librat e Shoqërisë ose nëpërmjet postës elektronike (email) të regjistruar në librat e Shoqërisë. Njoftimi për mbledhje me shkresë dhe/ose me postë elektronike me rendin e ditës i dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që kanë nënshkruar dhe zotërojnë të paktën 5% të kontributeve në kapitalin e Shoqërisë.

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori ose çdo person tjetër i autorizuar prej tij me shkrim për këtë qëllim është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të sekretarit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme dhe jashtëzakonshme.

### **Neni 13 Asambleja e Zakonshme**

Asambleja e zakonshme mbledhet çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

Vendimet e zakonshme merren nga ortaku me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë dhe që përfaqësojnë të paktën 70 % të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës së lartepërmendur, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

### **Neni 14 Asambleja e Jashtëzakonshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtëzakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.

Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.



Vendimet e jashtëzakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë dhe që përfaqësojnë të paktën 70 % të të gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës së lartpërmendur, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

### **Neni 15** **Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi**

Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e ushtrimit të votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Secili prej ortakëve ka të drejtën e një vote në mbledhjen e asamblesë e cila është e barabartë me vlerën e kontributeve të nënshkruara dhe shlyera dhe përlogaritët në proporcion me përqindjen e zotëruar dhe që përfaqëson në kapitalin e Shoqërisë.

Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, telekonferencës, videokonferencës apo mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë identifikuar dhe t'i jepet mundësia për të ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë në kohë reale nga një vendndodhje tjetër, duke përdorur masat teknike të nevojshme për sigurinë e mjeteve të komunikimit deri në masën e përdorimit proporcional për arritjen e qëllimeve. Nëse plotësohen dhe zbatohen këto kritere, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e procesverbalit përkatës të takimit si dhe nënshkrimin e tij nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

### **Neni 16** **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë për gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecures së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j) shpërndarjen e fitimeve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;



- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- m) çështje të tjera të caktuara nga ligji ose nga ky Statut.

### **Neni 17** **Administratori**

Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person/a fizik/ë, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas këtij Statuti.

Administratori /ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

Administrator i Shoqërisë është:

- (a) **Andrin Kurti**, i biri i Sulejman, shtetas shqiptar, lindur në Kukës më 10.10.1983 banues në Tiranë në adresën Rruga “ Don Bosko” Kompleksi. Fiori di Bosco, Shk 2, Kulla 3, Kati 4, Apt.22, i pajisur me kartë ID me nr. 036504924 dhe nr. Personal I31010152S, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

### **Neni 18** **Kompetencat e Administratorit/ëve**

Administratori/ët është/janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm.

Administratori/ët ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori/ët ka/në kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore, si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të autorizuar dhe i paraqet Asamblesë së Përgjithshme raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;



- h) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
- i) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

**Neni 19**  
**Viti financiar**

Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 20**  
**Dividendi**

Shoqëria do ti shpërndajë ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të ketë përmbushur të gjitha kërkesat dhe detyrimet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

**Neni 21**  
**Likuidimi**

Likuidimi i Shoqërisë vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakut në përputhje me kërkesat ligjore.

**Neni 22**  
**Dispozita mbyllëse**

Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Ky Statut është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

*Nënshkruar, sot më datë 23.03.2021*

**ORTAKËT**

**Andrin Kurti**

Andrin Kurti



**Bledar Muça**

Bledar Muça



**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“KRAM AL SH.P.K“**

**Neni 1  
Emri**

Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“KRAM AL SH.P.K“**, që këtu e më poshtë do të quhet **“Shoqëria”**.

**Neni 2  
Themelimi**

Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Statutin dhe këtë Akt Themelimi.

**Neni 3  
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: **Rruga Kavajes”, Kompleksi Square 21, Shk 1, Seksioni D, Kati 0, njesia D7&D8, Tiranë.**

Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4  
Ortakët e Shoqërisë**

4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:

- (a) **Andrin Kurti**, i biri i Sulejman, shtetas shqiptar, lindur në Kukës më 10.10.1983 banues në Tiranë në adresën Rruga “ Don Bosko” Kompleksi. Fiori di Bosco, Shk 2, Kulla 3, Kati 4, Apt.22, i pajisur me kartë ID me nr. 036504924 dhe nr. Personal I31010152S, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, zoterues i një kuote në vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me vlerën 100.000 ( njëqind mijë) Lekë. Vlera nominale e çdo kuote për çdo ortak është 100.000 (njëqind mijë ) Lekë.
- (b) **Bledar Muça**, i biri i Bahir , shtetas shqiptar, lindur në Dushk, Lushnjë më 21,04,1988 banues në Lushnjë në adresën Lagja Skënder Libohova, Rruga “





Vedut Dokollari” Shk 1, Kati 6, Apt.8, i pajisur me kartë ID me nr. 035470008 dhe nr. Personal I80421022C, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, zoterues i një kuote në vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë e barabartë me vlerën 100.000 ( njëqind mijë) Lekë. Vlera nominale e çdo kuote për çdo ortak është 100.000 (njëqind mijë ) Lekë.

## **Neni 5 Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 200.000 Lekë dhe është i ndarë në dy kuota, ku 1 kuotë në vlerën 50% e barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë zotërohen nga Ortaku Andrin Kurti dhe 1 kuotë në vlerën 50% e barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë zotërohen nga Ortaku Bledar Muça. Cdo kuote ka vleren nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë secila.

Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet 50% nga Ortaku Andrin Kurti dhe 50% Ortaku Bledar Muça sipas neni 4 të këtij Akti Themelimi.

Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji.

## **Neni 6 Objekti**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

- Ushtrimin e aktivitetit Bar-Bufe-Pastiçeri.
- Prodhim dhe shitje të produkteve të brumit.
- Prodhim dhe shitje të akulloreve dhe ëmbëlsirave.
- Prodhim dhe shitje të antipastave.
- Prodhim dhe/ose shitje të pijeve alkolike dhe joalkolike.
- Dhe çdo gjë tjetër që përdoret konform objektit kryesor të Bar-Bufe-Pastiçeri.

Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 7 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 8 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**



Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marre, por pa u kufizuar, vetem në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, emerimin e ekspertit kontabel, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

### **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**

Administratori i Shoqërisë është:

- (a) **Andrin Kurti**, i biri i Sulejman, shtetas shqiptar, lindur në Kukës më 10.10.1983 banues në Tiranë në adresën Rruga "Don Bosko" Kompleksi. Fiori di Bosco, Shk 2, Kulla 3, Kati 4, Apt.22, i pajisur me kartë ID me nr. 036504924 dhe nr. Personal I31010152S, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

Administratori emërohet për një periudhë **5 (pesë) vjeçare**, me të drejtë riemërimi. Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### **Neni 10 Ligji i Zbatueshëm**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

Çdo konflikt që mund të lindë në Shoqëri do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

***Nënshkruar, sot më datë 23.03.2021***

***Për KRAM AL SH.P.K***

**ORTAKËT**

**Andrin Kurti**

*Andrin Kurti*  


**Bledar Muça**

*Bledar Muça*  
